



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E EKONOMISË, PUNËSIMIT, TREGTISË, INDUSTRIJË, PREDUZETNIŠTVA I STRATEŠKIH ULAGANJAVE			
Nr./No. Org. Jedinica / Org. Unit	01	Nr./No. Ser. / Ser. No.	1740
Nr. i faqeve / Broj stranica / Pages	2	Data. / Datum / Date	12.04.2020
Prishtine / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Nr. 01/07
Prishtinë, 12.04.2020

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8.1.4 dhe shtojcës 7 pikat 20, 30 e 31 të Rregullores (QRK) nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe vendimeve nr. 01/07 të 11 marsit 2020, nr. 01/09 të 13 marsit 2020, nr. 01/10 të 14 marsit 2020, nr. 1/11 të 15 marsit 2020, nr. 01/15 të 23 marsit 2020, nr. 01/16 të 26 marsit 2020, nr. 02/17 të 27 marsit 2020, nr. 01/18 të 27 marsit 2020, nr. 01/22 të 5 prillit 2020 dhe nr. 01/24 të 8 prillit 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar tutje në Ligjin nr. 2004/18 për Tregti të Brendshme, i ndryshuar me ligjin nr. 04/L-005, dhe duke pasur parasysh kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, me qëllim të mbrojtjes së burimeve ujore dhe shëndetit publik gjatë pandemisë COVID-19, nxjerr këtë:

URDHËRESË

për ndryshimin dhe plotësimin e Urdhëresës MEPTINIS nr. 01/05 të 23 marsit 2020 për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik

1. Ndalohet veprimtaria "ndërtimi i projekteve të ujit", e klasifikuar me kodin 42.91 në NACE rev. 2.
2. Veprimtaritë e ndaluara përfshijnë:
 - 2.1. ndërtimin e rrugëve ujore, porteve, punimeve lumore, porteve të rekreacionit (marinave), mbyllësve në lumenj e kanale etj.;
 - 2.2. ndërtimin e pritave dhe pendave/digave;
 - 2.3. devijimet e rrjedhave ujore;
 - 2.4. ndërtimet e tjera që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në burimet ujore dhe natyrore dhe në pellgjet lumore.
3. Ndryshohet dhe plotësohet Urdhëresa MEPTINIS nr. 01/05 e 23 marsit 2020.

[Signature]

4. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Rozeta HAJDARI



Ministre në detyrë



U dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit
- zëvendëskryeministrave
- të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Inspektoratit i Tregut
- Inspektoratit i Punës
- inspektorateve komunale
- Departamentit Ligjor
- arkivit